



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05- 273  
Podujevë,  
22.07.2016

### Drejtoria për Arsim

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr.03 /L-068, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 06/2015 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 10.07.2015, vendimit të ministrit të MASHT-it nr.214/01B, i datës 23.07.2015, Udhëzimit Administrativ të MASHT – normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional nr. 05,i datës 07.07.2015 si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollave fillore, të mesme të ulta të komunës së Podujevës, drejtori i Drejtorisë për Arsim, shpall:

### Konkurs për mësimdhënës për vitin shkollor 2016/2017

- 1. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “ Shaban Shala “ Podujevë**
  - Dy (2) mësimdhënës për arsimin fillor
- 2. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “ Enver Maloku “ Podujevë**
  - Një (1) mësimdhënës për arsimin fillor;
- 3. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Drita”, Majac**
  - Një (1) mësimdhënës për arsimin fillor, me klasë të kombinuara
  - Dy (2) mësimdhënës për arsimin fillor në paralelen e ndarë në Popovë
- 4. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Rilindja”, Herticë**
  - Pesë (5) mësimdhënës të arsimit fillor, në shkollën amë
  - Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor me klasë të kombinuara, paralelja e ndarë në Surdull
  - Një (1) mësimdhënës të edukatës muzikore,4 orë

**5. Shkolla fillore dhe mesme e ulët “Musli Dumoshi”, Dumosh**

- Një (1) mësimdhënës të arsimit fillor,
- Një (1) mësimdhënës të edukatës muzikore, 4 orë

**6. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Zahir Pajaziti”, Orllan**

- Tre (3) mësimdhënës të arsimit fillor – me klasë të kombinuara në paralelen e ndarë në Brainë

**7. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Nuhi Gashi”, Bradash**

- Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor;

**8. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “ Sami Frashëri ”, Zhiti**

- Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor në Zhiti;
- Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor në paralelen e ndarë në Murgullë;

**9. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Ali Hadri”, Obranqë**

- Një (1) mësimdhënës të arsimit fillor – në paralelen e ndarë në Katunishtë;

**10. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Shefki Kuleta”, Tërnavë**

- Një (1) mësimdhënës të arsimit fillor në Tërnavë;
- Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor në Bellopojë;
- Tre (3) mësimdhënës të arsimit fillor në Halabak;
- Një (1) mësimdhënës të edukatës muzikore, 8 orë – shkolla amë dhe paralelet e ndara

**11. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Kadri Kadriu ”, Llaushë**

- Tre (3) mësimdhënës të arsimit fillor, - shkolla amë
- Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor, - paralelja e ndarë në Llaushë të Poshtme
- Tre (3) mësimdhënës të arsimit fillor, - paralelja e ndarë në Dumnicë të Epërme

**12. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Jahë Hasani”, Bërvenik**

- Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor, me klasë të kombinuara

**13. Shkolla fillore dhe e mesme e ultë “Shefki Latifi”, Pollatë**

- Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor, njëri në Pollatë, e tjetri në paralelen e ndarë në Sllatinë;

**14. Shkolla fillore dhe e mesme e ultë “Hamit Sejdiu”, Kërpimeh**

- Një (1) mësimdhënës të arsimit fillor,
- Një (1) mësimdhënës të arsimit fillor, në paralelen e ndarë në Pakashticë

**15. Shkolla fillore dhe e mesme e ultë “ Jetullah Gashi”, Dobërdol**

- Një (1) mësimdhënës të arsimit fillor,

**16. Shkolla fillore dhe e mesme e ultë “ Eqrem Çabej ”, Buricë**

- Tre (3) mësimdhënës të arsimit fillor,
- Një (1) mësimdhënës të edukatës muzikore, 4 orë

**17. Shkolla fillore dhe e mesme e ultë “ Naum Veqilharxhi ”, Llapashticë e Epërme**

- Një (1) mësimdhënës të edukatës muzikore, 6 orë

**18. Shkolla fillore dhe e mesme e ultë “ Ilir Konushefci ”, Llugë**

- Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor,

**19. Shkolla fillore dhe e mesme e ultë “ Jetullah Islami ”, Dyz**

- Katër (4) mësimdhënës të arsimit fillor,
- Një (1) mësimdhënës të matematikës, 15 orë në javë, me kohë të caktuar derisa të kthehet mësimdhënësja nga pushimi i lehonisë;

**20. Shkolla fillore dhe e mesme e ultë “ Elfir Behrami ”, Metehi**

- Dy (2) mësimdhënës të arsimit fillor,

**KUSHTET:**

**I. Aplikanti duhet t'i dorëzojë këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit ( i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14 e komunës)
- Certifikata e lindjes
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar), ose nostrifikimi i diplomës nëse kandidati ka të kryer ndonjë kualifikim jashtë Republikës së Kosovës
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,

- Dëshmi mbi përvojën e punës.
- Certifikatën e mjekut ( vetëm kandidatët të cilët pranojnë në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve )

## II. Kushtet dhe kriteret për zgjedhjen e kandidatëve për mësimdhënës

- Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional, nr. 04/L-138, Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, UA. 06/15 Për normativin për kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm,UA. 05/2015 Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional,

### Sqarim shtesë:

- Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente,
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT,
- Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 06/2015 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 10.07.2015 dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT – normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional nr. 05,i datës 07.07.2015 , por në mungesë të kuadrit adekuat mund të ftohen edhe kandidatët me kualifikim të përafërt,
- Kandidatët që konkurrojnë në dy pozita do të intervistohen vetëm për njërin pozitë e që intervista vlen për të dy pozitat,
- Intervista me kandidatë për mësimdhënës **mbahet në SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" në Podujevë**, sipas orarit të intervistimit i cili do të publikohet me kohë në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës).
- Dokumentet nuk kthehen.

### Afati i konkursit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik,në tabelën e shpalljeve të objektit të Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve>.


  
**Drejtori**
  

  
**Avni Maloku**